



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Rektori: Prof. Dr. Bajram Kosumi Ref.nr. 01/2050 Dt. 20/09/2021

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, si dhe nenit 47, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit në mbledhjen e XXVII-të, të mbajtur më datë 16.09.2021, merr vendim për të shpallur:

K O N K U R S

Për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, për vitin akademik 2021/2022.

Fakulteti Juridik

Një mësimdhënës për lëndët: E drejta penale- pjesa e përgjithshme; E drejta penale e avancuar-pjesa e përgjithshme; E drejta penale- pjesa e posaçme; E drejta e procedurës penale- pjesa e posaçme; Klinika juridike penale.

Fakulteti Ekonomik

Një mësimdhënës për lëndët: Financa; Financa ndërkombëtare; Ekonomiksi monetar; Sistemi monetar evropian dhe lëndët tjera nga fusha e financave.

Një mësimdhënës për lëndët: Mikroekonomi; Makroekonomi; Financat e korporatave; Afarizëm bankar dhe lëndë tjera nga fusha e ekonomiksit.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike

Një mësimdhënës për lëndët: në studimet bachelor - Qarqe dixhitale; Rrjeta kompjuterike; Sisteme të shpërndara; E-governance; IT dhe ndërrmarësi; dhe lëndën Sistemet virtuale në programin Master E- Qeverisja.

Një mësimdhënës për lëndët: në studimet bachelor -Inxhinieri Softuerike; Teknologji komunikimi në biznes; Biznesi dixhital; Menaxhimi i sistemeve kompjuterike; dhe lëndët Kompjuteristikë dhe Menaxhimi i sistemeve të informacionit në programin master E- Qeverisja.

Fakulteti i Shkencave Aplikative

Një mësimdhënës për lëndët: Gjeometri Elementare; Seminar nga Gjeometria dhe Didaktikë e matematikës në Programin Matematikë Arsimore me plotësim norme në Fakultetin e Edukimit në lëndët Metodologji e mësimi të matematikës në Programet Fillor dhe Parashkollor;

Një mësimdhënës për lëndët: Gjuhë angleze I dhe II në Programin Matematikë Arsimore, me plotësim norme në Fakultetin e Edukimit, Programi Parashkollor Gjuhë angleze I dhe II dhe Fakultetin Juridik, Programi juridik i përgjithshëm, Gjuhë Angleze I dhe II.

Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesën;
- Biografinë (CV);
- Kopjen e diplomës të studimeve themelore, masterit dhe doktoratës, të noterizuara (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellë më parë);
- Certifikatën e notave në tri nivelet e studimit (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellë më parë);
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës) ;
- Dëshmi (kopjet) për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënies në arsimin e lartë;
- Certifikatë nga gjykata, se ndaj tij nuk janë duke u zhvilluar hetime;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore.

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet baçelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i .

Kandidatët duhet të sjellin njërin prej këtyre dokumenteve si dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore:

1. Të kenë të kryer njërin nivel të studimeve në gjuhën e huaj ose certifikatë IELTS, TOEFL, TOEIC apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, Statutin e Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, (shih:<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2020/12/STATUTI-I-UNIVERSITETIT-%E2%80%9DKADRI-ZEKA%E2%80%9D-N%C3%8B-GJILAN.pdf>) dhe Rregullores Nr.01/1336 dt.18.06.2021 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në ueb-faqe.

Paraqitja e dokumenteve: Kërkesa protokollohet në zyrën nr. 4.

Aplikantët duhet të plotësojnë formularin F1 të cilin mund ta shkarkojnë nga ueb-faqja e universitetit, dhe në mënyrë elektronike së bashku me dokumentet e tjera e dërgojnë në info@uni-gjilan.net si dhe i tërë dokumentacioni sjellët në kopje fizike në UKZ.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit:

<http://www.uni-gjilan.net>